

Nishor/Nišor [Suharekë/Suva Reka]. Pesë ditë më vonë, ai nga plagët e mara ndërroi jetë dhe u varros në Nishor/Nišor. Pas lufte, më 18.09.1999, mbetjet e tij mortore janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Suharekë/Suhareka.

**Burimet:** ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.P.241B, FDH-5838; fotografi, FDH-20988; SHFĐUÇK, *Feniksët...4*, 311-314; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

### Zeqir (Asllan) Asllani

(2.11.1900, shqiptar nga fshati Rancë/Rance, komuna e Shtimes/Štimlje, bujk, pesë fëmijë)

Familja e Zeqirit të moshuar e kishte braktisur fshatin Rancë/Rance në fund të korrikut të vitit 1998, por ai qëndroi në fshat. Pas dhjetë ditësh, djali i Zeqirit, Rifati, u kthye për ta bindur babanë që tu bashkohet, por Zeqiri ishte këmbëngulës në vendimin e tij për ta mos braktisur shtëpinë. Forcat serbe kishin hyrë në **Rancë/Rance** më **26.08.1998**. Të nesërmen, pas tërheqjes së tyre, pjesëtarët e UÇK-së e kishin gjetur trupin e Zeqirit afër shtëpisë së tij. Ata e varrosën po atë ditë, afër vendit ku e kishin gjetur.

**Burimet:** deklarata M.A, FDH-25910; deklarata A.B, FDH-23607; deklarata M.A, FDH-36721.

### Skënder (Zeqir) Salihaj

(6.05.1972, shqiptar nga Mollopolci/Malopoljce, komuna e Shtimes/Štimlje, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Skenderi kishte studiuar në Fakultetin e Edukatës Fizike në Prishtinë/Priština. Në mars të vitit 1998, aderoi në UÇK. Në datën **13.09.1998**, mori pjesë në sulmin ndaj policisë serbe në hyrje të **Shtimes/Štimlje**. Gjatë shkëmbimit të zjarrit, ai u plagos rëndë. Shokët e bartin në spitalin e improvizuar në fshatin Llanishtë/Lanište, por aty ndërroi jetë. Në mbremje vonë, Skenderin e varrosën në varrezat në Mollopolc/Malopoljce.

**Burimet:** deklarata H.I, FDH-23594; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; fotografi, FDH-25070; SHFĐUÇK, *Feniksët...4*, 289-292.

### Xhemshir (Emin) Xhemshiri

(30.03.1957, shqiptar nga Petrova/Petrovo, komuna e Shtimes/Štimlje, bujk, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Xhemshiri nga viti 1980 deri në 1987 kishte punuar në Zvicër. Pas kthimit në vend, merrej me bujqësi dhe punët ndërtimore. Kur filluan konfliktet në Kosovë, Xhemshiri aderoi në UÇK. Xhemshiri ndërroi jetë më **28.09.1998**, në luftimet me forcat serbe në periferi të fshatit **Petrovë/Petrovo**. Trupi i tij kishte mbetur në vendin e vrasjes deri në mbremje, kur e nxorën bashkëluftëtarët. Në të njëjtën natë, ai u varros në varrezat e fshatit Petrovë/Petrovo.

**Burimet:** deklarata S.H, FDH-23601; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; fotografi FDH-25070; fotografi FDH-19086.

### Ranko (Stajko) Đorđević

(13.12.1963, serb nga Prekoci/Prekovce, komuna e Novobërdës/Novo Brdo, dy fëmijë, teknik i makinerisë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Ranko kishte punuar në kooperativën bujqësore në fshatin Prekoc/Prekovce dhe ishte pjesëtar i njësisë rezerve të MPB të Serbisë, ndërsa në maj të vitit 1998, mori thirrjen për NJPP. Në datën **12.10.1998**, rreth orës 13:30, Ranko me kolegët e vetë po kalonte me traktor nëpër fshatin **Karaqicë/Karačica**, me ç'rast ndaj tyre u hap zjarri. Ranko ndërroi jetë në vend. Ai u varros më 13.10.1998, në varrezat e fshatit Prekoc/Prekovce.

**Burimet:** deklarata M.Đ, FDH-9181; FHP, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, XX, 190; SMIP, *Teroristički...*, III, 941; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 25.

### Enver (Bajram) Qerimi

(22.01.1967, ashkali nga fshati Belincë/Belince, komuna e Shtimes/Štimlje, bujk, pesë fëmijë)

Enveri jetonte me familje në Belincë/Belince. Në datën **21.10.1998**, e kishte lëshuar bagëtinë në kullotë, në livadhet në drejtim të **Shtimes/Štimlje**. Familjarët kurrë më nuk e kishin parë të gjallë, ndërsa zhdukjen e tij e kanë paraqitur në polici më